



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI

STATISTIKOR

Janar - Qershor
2021

Buletini nr. 1

Janar - Qershor

2021

Buletini i parë statistikor i vitit 2021, përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën janar – qershor 2021. Në këtë buletin përfshihen, dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E), masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të përcjella në Prokurori.

Buletini përgatitet nga Sektori i Komunikimit, Botimeve dhe e Marrëdhënieve me Jashtë (sektori i statistikës).

Kontrolli i Lartë i Shtetit.

KLSH DHE AKTIVITETI AUDITUES PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2021		Faqe
I	TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE	7
II	Shkeljet me dëm ekonomik	14
II.a	<i>Shkeljet me dëm ekonomik: Në fushën e të ardhurave</i>	15
	Në sektorin e Tatim-Taksave	15
	Në fushën të Tjera	15
II.b	<i>Shkeljet me dëm ekonomik: Në fushën e shpenzimeve</i>	16
	Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore	17
	Në fushën e prokurimeve	17
	Në fushën e shpenzimeve operative	19
	Në fushën të Tjera	19
III	Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara	20
III.1	Në fushën e të ardhurave	21
III.2	Në fushën e shpenzimeve	22
IV	Auditimet me opinion	28
IV.1	Dhënie opinionit për auditimet financiare	28
IV.2	Dhënie opinionit për auditimet e përputhshmërisë	30
IV.3	Dhënie opinionit mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë	31
V	Auditimet e Performances	32
VI	Rekomandimet sipas natyrës	49
VII	Kallëzimet penale	51

Anekse

<i>Evidenca nr. 1:</i> Institucionet e audituara nga KLSH	53
<i>Evidenca nr.2:</i> Shkeljet me dëm ekonomik	55
<i>Evidenca nr.3:</i> Evidenca e pasqyrimin të parregullive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit	56
<i>Evidenca nr.4:</i> Masat Disiplinore dhe Administrative	57
<i>Evidenca nr.5:</i> Masat për Ndryshime apo Përmirësime ligjore	58
<i>Evidenca nr.5.1:</i> Masat Organizative	59
<i>Evidenca nr.6:</i> Kallëzimet Penale	60
<i>Evidenca nr.7:</i> Evidenca e ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH	61

KLSH DHE AKTIVITETI AUDITUES PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2021

I. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik, për periudhën janar-qershor 2021 kishte planifikuar gjithsej 89 auditime, vijoi puna audituese për përgatitjen e 122 raporteve të auditimit, nga të cilat duke u orientuar drejt përmbushjes së detyrimeve ligjore janë evaduar 27 misione auditimi.

27 misionet e auditimit të evaduara janë detajuar si më poshtë:

- 5 auditime përputhshmerie
- 7 auditime përputhshmërie dhe financiare¹
- 5 auditime performance
- 2 auditime financiare
- 8 auditime tematike

Rezultatet e punës audituese për gjashtëmuajorin e parë 2021 kanë pasur objektiv edhe identifikimin e shkeljeve dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik² dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike nga subjekteve nën auditim³.

Niveli i dëmeve ekonomike dhe shpenzimeve joefektive të konstatuara nga KLSH gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Shkeljet me dëm ekonomik



Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej **155,997 mijë lekë ose 1.3 milionë euro**.

¹ KLSH ka kryer 7 auditime rregullshmërie, klasifikuar si auditime mikse, për të cilat janë dhënë 7 opinione për pasqyrat financiare dhe 6 opinione përputhshmërie për 6 auditime mix. Në auditimin e zhvilluar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është dhënë dhe opinion për pasqyrat financiare për Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Durrës.

² Dëmi ekonomik në aktivitetin auditues i referohet detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet autoritetit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

³ Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.



Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej **2,614,539 mijë lekë**, afërsisht **21.3 milionë euro** nga e cila:

I. **1,033,372 mijë lekë** në fushën e të ardhurave, afërsisht **8.4 milionë euro**;

II. **1,581,167 mijë lekë** afërsisht **12.8 milionë euro**, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara, i referohen përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet në fushën e prokurimit publik shoqëruar me mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit, të cilat në shumë raste rezultojnë të realizuara jo në përputhje me kuadrin ligjor.



Puna audituese është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë rrishtu. Edhe gjatë kësaj periudhe, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë proceduriale dhe ineficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjisllacionit fiskal.

Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Tabela nr.1

I. Dëm ekonomik në të ardhura	000/lekë
Nga shkeljet në zbatimin e legjisllacionit tatimor	14,000
Të tjera	46,794
Totali i Dëmit ekonomik në të ardhura	60,794
II. Dëm Ekonomik në shpenzime	
Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	13,113
Në shpenzimet operative	4,832
Në shpenzimet për investime	74,356
Të tjera	2,902
Totali i Dëmit ekonomik në shpenzime	95,203
Totali i dëmit ekonomik (I+II) = 155,997 mijë lekë ose 1.2 milionë euro	

Të ardhura apo shpenzime të realizuara në kushtet e parregullsive në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi dhe në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve për periudhën janar – qershor 2021.

Tabela nr.2

I.	Efekte Negative në të Ardhurat e Buxhetit	000/lekë
1	Nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit tatimor	398,073
2	Të tjera	613,480
3	Në urbanistikë	21,819
	Totali	1,033,372

II.	Efekte Negative për Shpenzimet e Buxhetit	000/lekë
1	Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	960,241
2	Në shpenzimet për Investime	445,768
3	Të tjera	175,158
	Totali	1,581,167

Totali i efekteve negative në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit është 2,614,539 mijë lekë ose 21.3 milionë euro.



Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit




Në gjashtëmuajorin e parë të 2021, auditimet kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 38 subjekte. Ato kanë përfshirë, institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki), drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, fonde speciale, si dhe shoqëri aksionare me kapital shtetëror, në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shpërndarja e auditimeve sipas institucioneve.

Tabela nr.3 Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:	Nr
Institucione të qeverisjes qendrore	6
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	6
Institucione të tjera financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe institucionet vartëse financiare	1
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	4
Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	4
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performances	17
TOTALI I SUBJEKTEVE	38

Grafik nr.1 Subjektet e audituara në periudhën janar – qershor 2021



Burimi KLSH

Trajtimi i Letrave të qytetarëve

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2021 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit, duke i orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për ti marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.

Përgjatë kësaj periudhe KLSH ka trajtuar 181 letra dhe ankesa, nga të cilat 35 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 146 ankesa në kompetencë të KLSH, 130 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 16 janë në proces verifikimi.


Trajtimi i kërkesave për të drejtën e informimit

E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe tani e parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë, është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Që me miratimin e ligji të ri nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion nga viti në vit, të ardhura nga individë, subjekte të ndryshme dhe OJF. Vetëm gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2021 janë trajtuar dhe u është

përcjellë informacioni i kërkuar 14 kërkesave, të ardhura në adresën e koordinatorit të informimit të KLSH-së.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 15% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 8% në fushën e taksave, tatimeve, 57% administrimit dhe kthimit të pronës dhe 13% fushave të tjera dhe 7% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafik nr. 2 Fushat kryesore të shqetësimit publik




Burimi KLSH

Rekomandimet sipas natyrës

Në institucionet e audituara, KLSH-ja gjatë periudhës janar – qershor 2021, ka adresuar gjithsej 631 rekomandime, nga të cilat: 33 janë përmirësime ligjore, 409 rekomandime organizative dhe 189 masa rekomandime disiplinore dhe administrative.

Grafik nr.3 Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën janar - qershor 2021



Burimi KLSH

Kallëzimet Penale

KLSH ka luftuar pa kompromis ndaj abuzimeve dhe mashtrimeve financiare me pronën publike, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike nëpërmjet thellimit të luftës pa kompromis ndaj zyrtarëve të korruptuar, kryesisht adresimin e kallëzimeve penale me akuzat “Shpërdorim detyre”, “Shkelje e barazisë në tendera”, etj.

KLSH nga auditimet e realizuara në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021 ka përcjellë në Prokurori **2 kallëzime penale**.

Treguesit e dëmit ekonomik

Niveli i dëmit ekonomik dhe shpenzimeve joefektive apo me efekte negative (EEE) në buxhetin e shtetit në mënyrë të përmbledhur nga aktiviteti auditues përgjatë periudhës janar – qershor 2021 paraqiten si më poshtë:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej **155,997 mijë lekë** ose **1.3 milionë euro**.

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej **2,614,539 mijë lekë**, afërsisht nga e cila:

I. **1,033,372 mijë lekë** në fushën e të ardhurave, afërsisht 8.4 milionë euro;

II. **1,581,167 mijë lekë** afërsisht 12.8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Në total janë konstatuar shkelje në shumën **2,770,536 mijë lekë** ose afërsisht **22.6 milionë euro**.

**Kursi i këmbimit të lekut/euro është kursi i Bankës së Shqipërisë i datës 30.06.2020, 1 euro= 122.6 lekë.*

Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2019-2020 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

II.SHKELJET ME DËM EKONOMIK


KLSH ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik në të ardhura dhe shpenzime, në shumën totale prej **155,997 mijë lekë**, nga e cila ka rekomanduar për shpërblim dëmi shumën **155,997 mijë lekë**.

Tabela nr.4

I	Dëmi ekonomik sipas fushave	000/Lekë
1	Nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit tatimor	14,000
2	Të tjera	49,696
3	Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	13,113
4	Në shpenzimet operative	4,832
5	Në prokurime publike	74,356
TOTALI I DËMEVE PËR PERIUdhËN JANAR - QERSHOR 2021		155,997


Burimi KLSH

Grafik nr.4 Dëmi ekonomik sipas fushave në mijë lekë



Burimi KLSH

Grafik nr.5 Dëmi ekonomik sipas fushave në milionë lekë



Burimi KLSH

Parregullsitë dhe shkeljet financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik, janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 2, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

DËMI EKONOMIK


II.a) Në fushën e të ardhurave

Tabela nr.5 Dëmi ekonomik në fushën e të ardhurave

Dëm Ekonomik	000/lekë
Në fushën e tatim taksave	14,000
Të tjera	46,794
Totali	60,794

Burimi KLSH

Grafik nr. 6 Dëmi ekonomik në të ardhura (në mijë lekë) për periudhën janar - qershor 2021



Burimi KLSH

2.1 Në sektorin e Tatim – Taksave, në vlerën e përgjithshme prej 14,000 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

- Bashkia Këlcyrë, në vlerën 11,000 mijë lekë, si pasojë e mosllogaritjes sipas ligjit të tarifës për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në bashkinë Këlcyrë dhe njësitë administrative (Dishnicë, Sukë dhe Ballaban).
- Bashkia Konispol, në vlerën 3,000 mijë lekë, si pasojë e mospajisjes me leje apo autorizim/licencë përkatëse për tregtimin e karburantit dhe moskryerjes së pagesës së taksës për 3 subjekte që tregtojnë karburante dhe derivatet e tyre.

2.2 Në fushën Të Tjera, në shumën e përgjithshme prej 46,794 mijë lekë.

- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë, në vlerën 46,794 mijë lekë, nga të cilat:
 - 42,826 mijë lekë, si pasojë e veprimeve/mosveprimeve dhe mospasqyrimin të llojit të shkeljes dhe sasisë së drurit të transportuar

në mënyrë të paligjshme, në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, në vendimin përfundimtar të inspektimit. Nuk është mbajtur procesverbali i llogaritjes së dëmit të shkaktuar në ekonominë pyjore dhe nuk janë marrë masa për sekuestrimin e lëndës drusore të transportuar në mënyrë të paligjshme.

- 1,700 mijë lekë, si pasojë shfuqizimit/ndryshimit në mënyrë të padrejtë, për masën e gjobës së vendosur nga inspektorët gjatë inspektimeve në terren.
- 1,598 mijë lekë, si pasojë e mosvendosjes së gjobave në rastin e konstatimit të shkeljeve nga grupi i inspektorëve, mosaplikimin e penalteteve ndaj subjekteve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacionin brenda afatit të kërkuar, duke penguar kryerjen e inspektimit.
- 670 mijë lekë, si pasojë e konstatimit në 5 raste veprime/mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore ndaj agjencive dhe operatorëve turistik.

II.b) Në fushën e shpenzimeve

Tabela nr.6 Përmbledhja e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në fushën e shpenzimeve

Dëm Ekonomik	000/lekë
Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	13,113
Në shpenzimet operative	4,832
Në shpenzimet për investime	74,356
Të tjera	2,902
Totali	95,203

Burimi KLSH

Grafik nr. 7 Dëmi ekonomik në shpenzime (në mijë lekë) për periudhën janar – qershor 2021



Burimi KLSH

2.1 Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, në vlerën e përgjithshme prej 13,113 mijë lekë, konstatuar në institucionet:


- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në vlerën 7,597 mijë lekë, si pasojë e likuidimeve për 110 vendimeve gjyqësore të ekzekutuara për vitin 2019 dhe 2020.
- Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, në vlerën 3,529 mijë lekë, si pasojë e rialokimit të fondeve për pagesat e dëmshpërblimeve për lirim nga shërbimi civil në punësimin me kod pune pa ndryshuar funksionin dhe vendin e punës për 12 punonjës.
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në vlerën 1,523 mijë lekë, si pasojë e përfutimit padrejtësisht të shpërblimit të veçantë për këshillin mbikëqyrës dhe stafin e tij në kundërshtim me VKM nr.570 datë 03.10.2018 “Për Këshillin Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 6.
- Projekti: Ofrimi shërbimeve publike me në qendër qytetarin", ADISA, në vlerën 464 mijë lekë, si pasojë e pagesave pa dokumentacion justifikues (listë prezencë) për vitin 2018 dy punonjës si dhe në vitin 2019 paguar pa dokument justifikues (listë prezencë) gjashtë punonjës, diferenca këto që pasqyrohen me tepri në llogaritë 600 të secilit vit.

2.2 Dëmi ekonomik i rezultuar në fushën e prokurimit të nevojave për mallra/shërbime/investime publike, kap vlerën e përgjithshme 74,356 mijë lekë. Dëmi është konstatuar si në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ashtu edhe në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve

Problematikat e konstatuara nga auditimet lidhen jo vetëm me planifikim jo të drejtë të nevojave por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Mangësitë i referohen implementimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik, fakt që lidhet edhe me kapacitetet njerëzore jo gjithmonë profesionale, që përfshihen në realizimin e këtij procesi. Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve publike konstatohet si shkelje në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik; paraqitjen dhe pranimin e ofertave; hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në konkurim; në njoftimin e fituesit, në procedurat e prokurimit me një ofertues, në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët, arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar; zbatimin e kontratave nga kontraktorët në përputhje me kushtet e përgjithshme etj. Në total, për periudhën janar – qershor 2021, vetëm nga auditimi i procedurave të prokurimit ka një dëm ekonomik në shumën 74,356

mijë lekë nga të cilat vlera 27,234 mijë lekë në procedurë prokurimi dhe vlera 47,122 mijë lekë gjatë zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.

Grafik nr.8: Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve në %



Burimi KLSH

2.2.1 Shkelje në realizimin e procedurave të prokurimit

Shkeljet në procedurat e prokurimit në 4 subjekte, kanë sjellë një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën 27,234 mijë lekë. Shkeljet kanë rezultuar në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, në skualifikimet e ofertuesve, në hapjen e shqyrtimin e ofertave, në ofertat anomalisht të ulta dhe zhvillohen procedura prokurimi me një pjesëmarrës dhe fitues njëkohësisht.

Tabela nr. 8 Dëmi ekonomik i konstatuar në realizimin e procedurave të prokurimit

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër	20,034
Bashkia Krujë, Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	5,627
Bashkia Konispol	1,219
Bashkia Këlcyrë	354
Totali (në mijë lekë)	27,234

Burimi KLSH

2.2.2 Shkelje në zbatimin e punimeve, në institucionet si më poshtë:

Shkeljet në zbatimin e kontratave për 8 subjekte, kanë sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën 47,122 mijë lekë. Shkeljet e këtij grupimi fillojnë me problemet në lidhjen e kontratave, aktet e marrjes në dorëzim, në mungesa apo problematika në kryerjen e punimeve të ndërtimit, inventarizim dosjesh etj.

Tabela nr.9 Dëmi ekonomik i konstatuar në zbatimin e punimeve

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	18,715
Bashkia Korçë	11,082
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	6,417
Bashkia Këlcyrë	4,989
Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër	3,656
Bashkia Krujë, Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	1,478
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	413
Bashkia Konispol	372
Totali (në mijë lekë)	47,122

Burimi KLSH

2.3 Në fushën e shpenzimeve operative, në vlerën e përgjithshme prej 4,832 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Tabela nr. 10

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	2,465
Bashkia Korçë	1,935
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	247
Bashkia Konispol	185
Totali (në mijë lekë)	4,832

2.4 Në fushën Të Tjera, në shumën e përgjithshme prej 2,902 mijë lekë

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në vlerën 2,902 mijë lekë, nga të cilat:
 - 1,863 mijë lekë është vlera e medikamenteve të skaduara e bërë hyrje në Qendrën Spitalore të Burgjeve në vitin 2019. Nga kjo rezulton se 10% e vlerës furnizimit me medikamente nga kontrata e vitit 2019, ka skaduar po në atë vit. Kjo vjen së pari nga pranimi i medikamenteve në kundërshtim me kushtet e kontratës përse i përket afatit të skadencës, ku në specifikimet teknike të kontratës përcaktohet se “medikamentet duhet të kenë afat skadence jo më pak se 1.5 vite nga momenti i pranimi në magazinën e DPB” dhe së dyti nga një proces planifikimi i pabazuar në nevoja konkrete. Kjo tregon mosplanifikim të drejtë sipas nevojave për medikamente në vitin 2019 dhe përdorim të fondeve pa efikasitet dhe efektivitet;
 - 937 mijë lekë, si pasojë përfitimit të dietave për punonjësin që prej


shkurtit 2019 është emëruar si drejtor i komanduar në IEVP Korçë për një periudhë 23 muaj në kundërshtim me ligjin për Policinë e Burgjeve, ku përcaktohet se komandimi nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

- 100 mijë lekë, si pasojë e mosndërprerjes së përdorimit të medikamentit Ranitidinë, i cili raportohet nga FDA, EMA dhe AKBPM, që përmban elementë kancerogjenë. Ky medikament duhet të ishte kthyer te furnitori dhe duhet të ishte bërë rimbursimi.

III. SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE ME NDIKIM NEGATIV NË PERFORMANCËN E ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE DHE NË PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET E AUDITUARA

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë periudhës janar - qershor 2021, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale **2,614,539 mijë lekë** nga të cilat: **1,033,372 mijë lekë** në fushën e të ardhurave dhe **1,581,167 mijë lekë** në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor. Në grafikun e mëposhtëm ilustrohen shkeljet e disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Grafik nr.10 Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mijë lekë




Burimi KLSH

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 3, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

III.1 Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në administrimin e të ardhurave

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave për subjektet e audituara, arrin vlerën 1,033,372 mijë lekë.

Grafik nr.11: Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave (mijë lekë)



Burimi KLSH

Efektet negative të lidhura me administrimin e sistemit tatimor & doganor, nga qiratë & privatizimit, koncensionet, urbanistikës dhe në fushën të tjera

- Bashkia Këlcyrë, në vlerën 70,302 mijë lekë, nga të cilat:
 - 60,386 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve të subjekteve fizik/juridik për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 220 subjekte për vlerën 22,853 dhe 3360 familje për vlerën 37,534. Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe asnjë procedurë tjetër, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezulton e dështuar, sidomos për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave numrin e llogarisë bankare, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.
 - 9,915 mijë lekë, si pasojë e mospërputhjeve të theksuara midis planifikimit të të ardhurave nga taska për tokenë bujqësore dhe asaj çfarë duhet të ishte

planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në Bashki, për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

- Bashkia Konispol, në vlerën 33,507 mijë lekë, nga të cilat:
 - 29,265 mijë lekë, si pasojë e mosmarrjes së masave për nxjerrjen e njoftimit për vlerësimet tatimore për debitorët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2020.
 - 4,242 mijë lekë, si pasojë e moskontabilizimit dhe arkëtimin e gjobave të aplikuara për ndërtime pa leje dhe shkelje të ndryshme të kryera nga subjektet private.
- Bashkia Korçë, në vlerën 316,083 mijë lekë, nga të cilat:
 - 294,264 mijë lekë, si pasojë e mosndjekjes së procesit për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore nga sektori i tatim taksave vendore. Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet e biznesit dhe familjarëve në shkallë bashkie është: Biznesi i madh dhe i vogël janë në vlerën 183,615 mijë lekë ose përbëjnë 62% të vlerës totale të borxhit dhe taksat dhe tarifave e familjes janë në vlerën 110,546 mijë lekë ose përbëjnë 38% të vlerës totale të borxhit.
 - 21,819 mijë lekë, si pasojë e mosmarrjes së masave lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI (ASHK).
- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë, në vlerën 613,480 mijë lekë, si pasojë e moslikujdimin dhe arkëtimin të 1353 gjoba për vitin 2017 deri në fund të vitit 2019.


III.2 Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e përdorimit të fondeve publike nga subjektet e audituara.

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion, arrin vlerën 1,581,167 mijë lekë.

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve kanë rezultuar në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në fushën e keqmenaxhimit të fondeve të programuara për

shpenzime operative, në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Grafik nr.12: Shkelje të disiplinës financiare në fushën e shpenzimeve



Burimi KLSH

Efekte financiare në fushën e pagave dhe shpërblimeve

- Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, në vlerën 90,597 mijë lekë, si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Nga raportimi i nëntëmujorit të DPB, rezultojnë të jenë likuduar 42 vendime më tepër, të cilat janë në kundërshtim me Strategjinë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura.
- Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, në vlerën 57,854 mijë lekë, nga të cilat:
 - 29,706 mijë lekë, si pasojë e 21 vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna të punonjësve; nga të cilat ekzekutuar vlera prej 14,087 mijë lekë dhe konstatuar 15,618 mijë lekë që i përkasin vendimeve të formës së prerë të pa ekzekutuara deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve nga ana e ZVAP-eve nën juridiksionin e DRAP Durrës.
 - 28,148 mijë lekë, si pasojë e përfitimit të pagesës për dëmshpërblimin për 82 punonjës të liruar nga shërbimi civil pas miratimit të VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, ku strukturat përgjegjëse për ofrimin dhe sigurimin e arsimit cilësor në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar janë riorganizuar, proces ky i shoqëruar me kosto financiare për buxhetin e shtetit.
- Drejtorja e Rajonit Verior Shkodër, në vlerën 1,909 mijë lekë, si pasojë e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për vitin 2017 dhe 2018 për 7 punonjës të larguar nga puna në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbauesit dhe jo vullnetarisht por duke paguar sanksione.

- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në vlerën 809,881 mijë lekë, nga të cilat:
 - 686,657 mijë lekë, si pasojë e pagesave të përfituara për zërin paga në natyrë (dieta) jo në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga ana e administratorit të shoqërisë, drejtorisë juridike, drejtorisë së burimeve njerëzore nuk janë marrë masa për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor me vlerën 300 lekë në vakt/ditë punë, por është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Kjo konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë;
 - 105,285 mijë lekë, si pasojë e pagesave si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore për 89 çështje gjyqësore të humbura në apel, 45 çështje gjyqësore të humbura në Gjykatën e Lartë të Tiranës dhe 4 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së parë;
 - 17,938 mijë lekë, si pasojë e kryerjes së komandimeve të punonjësve në 6 raste nga Drejtoria e Përgjithshme për në Drejtoritë Rajonale, për periudha mbi një vjecare, duke akorduar krahas pagës së pozicionit të mëparshëm të punës edhe shpenzimet për udhëtime dieta jashtë vendbanimit. Vendimet e komandimit i kanë shkaktuar shoqërisë kosto shtesë, e cila rëndon buxhetin e shoqërisë me shpenzime pa efektivitet, duke pasur parasysh dhe rezultatin financiar negativ të saj, si dhe komandimi pa afat i punonjësve rrezikon të ndikojë negativisht në performancën e tyre dhe të punonjësve në varësi të tyre.

Efekte negative të lidhura me mungesa kontrolli nga strukturat shtetërore gjatë prokurimit të fondeve publike dhe realizim të procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor

Nga auditimet e realizuar janë konstatuar problematika të cilat lidhen me mungesën e sistemeve të kontrollit nga strukturat përgjegjëse të prokurimeve, shoqëruar me paligjshmëri të proceseve të prokurimit të fondeve publike, duke ulur efektshmërinë e qëllimit kryesor të ligjit për prokurimet publike, pra atë të sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar.

Në tabelën më poshtë kemi grupuar problematikën me një shtrirje dhe shpërndarje thuaj uniforme në strukturat e audituara.

Tabela nr.11

Subjektet me efekte negative në fushën e prokurimeve	Vlera në mijë lekë
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	130,609

Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër	81,226
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	71,537
Bashkinë Tiranë: Projekti i partneritetit publik privat, ndërtimi i shkollave	51,291
Bashkia Krujë: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	40,672
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	33,470
Bashkia Këlcyrë	23,968
Bashkia Konispol	12,646
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	349

Burimi KLSH

Problematikat janë konstatuar në institucionet:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në vlerën 130,609 mijë lekë nga të cilat:
 - 128,260 mijë lekë, si pasojë e kualifikimit të operatorëve ekonomik, të cilët kanë paraqitur aktet administrative AMHS të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë, të lëshuara 3 ose 2 vite përpara, pra jo në koherencë me realizimin e procedurës dhe jo në përputhshmëri me aktualitetin, duke humbur seriozitetin e kriterit të higjienës. Për rrjedhojë kjo vlerë përbën shpenzim, pa ekonomicitet, pa eficiencë dhe pa efektivitet të financuara nga fondet publike. Ekzistenca e mosplotësimit të elementëve të mësipërm, u konstatua dhe në procedurën me dy Lote: Loti I: Procedura me objekt “Blerje artikull ushqimor-bulmet dhe nënprodukte të tij” dhe Loti II: Procedura me objekt “Blerje artikull ushqimor-bukë”;
 - 2,349 mijë lekë, si pasojë e mungesës së kriterëve që lidhen me specifikimet e veçanta të kualifikimit në DT, mbi bazën e të cilave operatori ekonomik fitues ka tenderuar, duke konstatuar shpërndarje të produkteve me mjete motorike jo frigorifer, nuk janë paraqitur në emër të OE certifikatat shëndetësore veterinarë ose raport analizat e kryera nga AKU si dhe nuk janë paraqitur fatura tatimore të blerjes së mallrave për të verifikuar nëse produkti është blerë nga të tretët.
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, në vlerën 349 mijë lekë, nga të cilat:
 - 316 mijë lekë, si pasojë e shkeljeve të rezultuara në përlllogaritjen e vlerës së kontratës të procedurës së prokurimit me objekt “Modele pikturë për shkollën “Jordan Misja”, Tiranë. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit nuk ka argumentuar arsyen e përzgjedhjes së metodës së studimit të tregut, në hartimin e fondit limit dhe nuk ka argumentuar përzgjedhjen e OE të marrë në studim tregu. Në kushtet kur sipas verifikimeve të kryera në QKB, nga 3 OE e marrë në studim tregu, nuk kanë për objekt aktiviteti kryerjen e

shërbimeve të modelingut. Gjithashtu Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit nuk ka argumentuar përse nuk ka përzgjedhur si metodë të përlllogaritjes së fondit limit, vlerën e kontratave të mëparshme, në kushtet kur gjatë vitit 2018, ky shërbim është kryer me çmimin 267 lekë/ora.

- 32 mijë lekë, si pasojë e moslllogaritjes së dëmeve të likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve nga operatori ekonomik fitues për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Trajnim mësimdhënie në kurrikulën e re për drejtuesit e institucioneve arsimore mësues të arsimit bazë kurrikula e re, mësues të AML të trajnuar për kurrikulën e klasës së 10, 11 dhe 12”.
- Bashkia Tiranë për projektin e Partneritetit Publik Privat, “Ndërtimi i Shkollave”, në vlerën 51,291 mijë lekë, si pasojë e një analizë jo të saktë të kostove të ndërtimit pasi në të dyja rastet e shkollave dhe të kopshtëve preventivat e punimeve kanë të njëjtat zëra të punimeve (Punime Civile, Punime Mekanike, Punime Elektrike). Gjithashtu konstatohet konflikt interesi ndërmjet koncesionarit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit në shkelje të plotë të ligjit 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Pra mbikëqyrësi dhe kolaudatorit i punimeve është i konfliktuar në interesa për të realizuar punën e tij për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, pasi investitori në këtë rast është shoqëria Koncesionare dhe jo Bashkia Tiranë. Bashkia Tiranë për periudhën e realizimit të kontratës, nuk garantohet për zbatimin e cilësisë së punimeve, volumeve të punimeve, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin e zbatimit, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, etj. Vlera që do të paguhet koncesionarit për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e veprave, përbën përdorim pa efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Bashkia Krujë, Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë, në vlerën 40,672 mijë lekë, si pasojë e mos studimeve, projekteve të thelluara për forcimin strukturor të shkollës mbështetur edhe nga ngjarjet dhe rrethanat ku shkolla rezultoi e dëmtuar dhe e pashfrytëzueshme nga tërmeti i nëntorit 2019. Në projekt – preventivin e objektit “*Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre, Thumanë*” hartuar nga shoqëria Xh.M shpk nuk është parashikuar asnjë zë pune që ka të bëjë me përforcimin strukturor të shkollës ose ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit, pavarësisht se në narrativin e tij, relacioni citon që objekti është i dëmtuar si nga tërmeti i Korrikut 2018, ashtu edhe nga amortizimi i saj për shkak të vjetërsisë së objektit (viti 1964). Punimet ndërtimore të shkollës përfshijnë vetëm punime për përmirësimin e rifiniturës (suvatime, hidroizolime, shtresa, etj.) dhe punime elektrike dhe hidraulike. Ky

projekt ka shkaktuar përdorim pa efektivitet dhe eficiencë të fondeve të buxhetit të shtetit.

- Bashkia Këlcyrë, në vlerën 23,968 mijë lekë, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në 6 procedura prokurimi, në kundërshtim me aktet rregullative. Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të Operatorëve Ekonomikë (OE) të shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DT, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i AK, duke mosgarantuar përmbushjen me cilësi të kontratës, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të vendosura në DT. Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar paligjshëmëri në prokurimin e fondeve publike, me pasojë përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike.
- Bashkia Konispol, në vlerën 12,646 mijë lekë, si pasojë e shkeljeve të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej në 3 procedura, ku në 2 raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në 1 rast OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshëmëri të fondeve publike.
- Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër, në vlerën 81,226 mijë lekë, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet. Nga moszbatimi i procedurave të rregullta në hartimin e fondit limit ka sjellë rritjen e paargumentuar të fondit limit, duke rritur në këtë mënyrë vlerën e fondit që është përdorur për punime emergjente, shkelje në vlerësimin e procedurave nga KVO duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, por duke skualifikuar OE për shkaqe të cilat nuk cenon thelbin e zbatimit të kontratës.
- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë, në vlerën 33,470 mijë lekë, si pasojë e skualifikimit në mënyrë të padrejtë ofertën ekonomike, dorëzimi i draft-raportit përfundimtar 20 ditë me vonesë, mosvendosjen e penalteteve për vonesën dhe mosdorëzimin e 100 tabletave elektronike, dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderit “Pashaporta dixhitale mjedisore”, konstatohen se nga veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Kontraktor janë përdorur fonde publike jo në përputhje me parimet e ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficiencës.
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në vlerën 71,537 mijë lekë, si pasojë e përdorimit të fondeve publike pa eficiencë, efektivitet dhe

ekonomicitet për procedurat e realizuara për periudhën 2107-2019. Gjithashtu moszbatimi i kontratave në përputhje me specifikimet teknike të OE ofertues fitues, mosargumentimi dhe dokumentimi teknikisht dhe ligjërisht në çdo rast prokurimi për përlllogaritjen e fondit limit.


Efekte financiare në fushën të tjera

- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, në vlerën 157,423 mijë lekë, si pasojë e kryerjes së pagesave drejtëpërdrejtë në llogaritë për mësuesit dhe te Posta Shqiptare SHA për nxënësit nga Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar. Pagesa e drejtëpërdrejtë është në kundërshtim me kërkesat ligjore të këtyre shpenzimeve, gjithashtu mbart riskun e përdorimit pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në vlerën 2,223 mijë lekë, si pasojë e marrjes në dorëzim të medikamenteve në kundërshtim me kushtet e kontratës me afat skadence më të vogël se 1,5 vite, e cila rezulton të jetë menaxhuar pa eficiencë, pa efektivitet dhe pa ekonomikitet të fondeve të financuara nga buxheti i shtetit.
- Auditim Performance me temë: “Mëmësia e Sigurt: Kujdesi Shëndetësor Spitalor Natal dhe Postnatal”, në vlerën 15,512 mijë lekë, si pasojë e përdorimit të paketave të pajisjeve të sterilizimit të koncensionarit S.S. SHPK edhe pse reparti i gjinekologjisë dhe obstetrikës në spitalin Rajonal Vlorë dhe Korçë kanë autoklava për sterilizimin e pajisjeve mjekësore, për lindjet normale. Duke gjykuar me parimet e eficiencës dhe ekonomikitetit mund të themi se për SRV dhe SRK janë shpenzuar fonde publike për vitin 2019 në kundërshtim me këto dy parime.

IV.AUDITIMET ME OPINION

Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – qershor 2021, KLSH ka dhënë opinione për 14 misione auditimi, nga të cilat 2 janë opinione financiare, 5 opinione përputhshmërie dhe 7 janë opinione financiare dhe përputhshmërie.

Grafik nr.13 Opinionet e audituesit në %



Burimi KLSH

IV.1 DHËNIE OPINIONI PËR AUDITIMET FINANCIARE

Për periudhën janar – qershor të vitit 2021, KLSH ka kryer **2** auditime financiare nga të cilat janë auditime ku janë dhënë opinione të pamodifikuar me theksim çështje për projektet: Ofrimi i shërbimeve publike me në qëndër qytetarin, ADISA dhe Modernizimi i Asistencës Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Soziale.

Tabela nr. 12 Opinioni për auditimet financiare

Nr.	Subjektet	Opinioni i auditimit
-	-	Opinione të pamodifikuar ⁴
2	-Projekt: Ofrimi i shërbimeve publike me në qëndër qytetarin ADISA; -Projekt: Modernizimi i Asistencës Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Opinione të pamodifikuar (me theksim çështje)
-	-	Opinione të kualifikuar ⁵

⁴ Opinioni i pamodifikuar – Audituesi duhet të shpreh një opinion të pamodifikuar mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare kur ai/ajo konkludon se transaksionet financiare përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

⁵ Opinioni i modifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të modifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

-	Opinione të kualifikuar (me theksim çështjeje) ⁶
	Opinione të kundërt

Burimi KLSH

IV.2 DHËNIE OPINIONI PËR AUDITIMET E PËRPUTHSHMËRISË⁷

Bazuar në planin vjetor të auditimeve, për periudhën janar – qershor të vitit 2021, KLSH ka kryer **5** auditime përputhshmërie dhe janë dhënë opinione për 5 auditime, nga të cilat: **3** janë auditime ku janë dhënë opinione të modifikuar (2 me theksim çështje) në subjektet: Bashkia Tiranë për projektin Partneriteti Publik Privat, ndërtimi i shkollave; Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë dhe Operatori i shpërndarjes energjisë elektrike.

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (*auditim tematik*) dhe në Bashkinë Krujë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Projekti "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare + ndërtim palestere Thumanë", grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin e një Opinioni të Kundërt.

Tabela nr. 13 Opinioni për auditimet e përputhshmërisë

Nr	Opinioni i Auditimit	Subjektet
	Opinion i pamodifikuar	-
2	Opinion i modifikuar (me theksim çështje)	- Bashkia Tiranë për projektin Partneriteti Publik Privat, ndërtimi i shkollave - Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë
1	Opinione të modifikuar	Operatori i shpërndarjes energjisë elektrike

⁶ Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, "Opinion i me rezerve" do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

⁷ Opinioni i pamodifikuar – Audituesi duhet të shpreh një opinion të pamodifikuar mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare kur ai/ajo konkludon se transaksionet financiare përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Opinion i modifikuar – Objektivi i audituesit është të shpreh opinion të modifikuar në rastet kur:

- Audituesi konkludon që llogaritë përmbajnë gabime materiale ose transaksionet nuk përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi ose;
- Kur audituesi e ka të pamundur të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të nevojshme të auditimit, në mënyrë që të konkludojë se llogaritë nuk përmbajnë gabime materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

2	Opinione të Kundërt	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (<i>Tematik</i>) - Bashkinë Krujë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Projekti "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare + ndërtim palestre Thumanë"
	Refuzim për Opinion	-

Burimi KLSH

IV.3 DHËNIE OPINIONI MBI PASQYRAT FINANCIARE DHE OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË

KLSH, për periudhën janar – qershor të vitit 2021, ka kryer 7 auditime rregullshme, për të cilat janë dhënë opinione mbi pasqyrat financiare dhe opinione mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve të audituara për 6 auditime mix. Gjithashtu në auditimin e zhvilluar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është dhënë dhe opinion për pasqyrat financiare për Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Durrës.

Tabela nr. 14 Opinioni mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë

Nr.	Opinionit i auditimit	Subjektet
OPINION MBI PASQYRAT FINANCIARE		
1	I pamodifikuar	- Aparatit të Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar Durrës
3	I modifikuar	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve - Bashkia Korçë; - Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër
2	I Kundërt	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Këlcyre; - Bashkia Konispol
1	Refuzim i opinionit	- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës
OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË		
	I pamodifikuar (Pa rezervë)	---
	I pamodifikuar (Me rezervë)	---
2	I modifikuar	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve - Bashkia Konispol
4	I Kundërt	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës - Bashkia Korçë; - Bashkia Këlcyre; - Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër

Burimi KLSH

V.Auditimet e Performancës

Auditimi i performancës është shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Gjatë periudhës janar - qershor 2021, KLSH ka iniciuar 17 auditime dhe ka evaduar 3 auditime performance nga Departamenti i Auditimit të Performancës dhe 2 auditime nga Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit. Fushat ku janë përqendruar këto auditime kanë vijuar të jenë:

- Reformat qeveritare;
- Projektet dhe shërbimet social-kulturore;
- Projektet dhe shërbimet social-ekonomike;

Për secilin prej 5 auditimeve të performancës të zhvilluara nga Departamentet e Auditimit të Performancës dhe Aseteve dhe Mjedisit në KLSH përgjatë periudhës janar – qershor 2021, më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër me objektivat dhe fokusimet kryesore të këtyre auditimeve, shoqëruar me problematikat, gjetjet, konkluzionet si dhe rekomandimet që janë dhënë nga grupet e KLSH-së për përmirësimin e situatës.

EFEKTIVITETI I PROCESIT TË LEGALIZIMIT DHE NDIKIMI NË ADMINISTRIMIN E PASURISË PUBLIKE

Pyetja kryesore | A ka qenë efektiv procesi i legalizimit?

Mesazhi i auditimit:

Shtirja në kohë e procesit të legalizimit, përtej afateve ligjore të parashikuara, e ka shndërruar në një proces të tejzgjatur, duke denaturuar objektivin kryesor të tij “për të rregulluar efektin e madh social të ndërtimeve informale”, dhe ka “inkurajuar” tërthorazi ndërtimet informale, dhe jo reduktuar ato. Ecuria e tij ka hasur paqëndrueshmëri ndër vite në miratimin e lejeve të legalizimit, kjo e ndikuar kryesisht nga fakti se planet rregulluese vendore të bashkive nuk kanë qenë të përditësuar me ndryshimet demografike që kanë ndodhur në një zonë të caktuar. Objektivat strategjike në fushën e legalizimit nuk janë shoqëruar me plane veprimi të qarta, të cilat do të individualizonin proceset e punës të secilit institucion që ndërlidhet me fushën e legalizimeve të ndërtimeve informale dhe do të bënin të mundur realizimin e tyre. Qasja e deritanishme legjislative dhe organizative për procesin e legalizimeve është e drejtuar drejt përmirësimit por ende evidentohen problematika thelbësore. Reduktimi i kritereve për legalizim nuk ka eliminuar tërësisht aspektet burokratike ndaj shërbimit të qytetarëve, njëkohësisht vërehet se ka ulur nivelin e garancive ligjore që mbrojnë pronën publike (veçanërisht zonat bregdetare).

Subjektet e audituara:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës

Periudha e auditimit: 2018 – 2020.

Mbi Auditimin

Ky auditim synoi të analizojë shtrirjen në kohë të procesit të legalizimit, përtej afateve ligjore të parashikuara, e cila e ka shndërruar në një proces të tejzgatur, duke denaturuar objektivin kryesor të tij *“për të rregulluar efektin e madh social të ndërtimeve informale”*. Duke marrë shkas nga ndryshimet e reja ligjore, të cilat përbëjnë një reformim të ri, puna audituese është shtrirë edhe në dhënien e një vlerësimi mbi bazën e re ligjore, me qëllim që auditimi të mos humbasë koherencën me zhvillimet e reja, por të dalë në rekomandime që adresojnë problematika aktuale, që barten edhe nga legjislacioni i ri.

Lidhur me gjetjet kryesore të këtij auditimi subjekteve të audituar, ndër të tjera, u është rekomanduar marrja e masave të mëposhtme:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për hartimin e një strategjie të re për procesin e legalizimit, në bashkëpunim me bashkitë e vendit, shoqëruar me plane veprimi të qarta, të cilat do të individualizonin proceset e punës të secilit institucion që ndërlidhet me fushën e legalizimeve të ndërtimeve informale si dhe të përcaktohen objektiva për marrjen e masave për reduktimin e informalitetit.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për unifikimin e hartografisë mes sektorit të regjistrimit (ish-ZRPP) dhe sektorit të legalizimit, me qëllim shmangien e fenomeneve të zhvendosjeve të objekteve, kompensimeve dhe shpronësimeve të paqena të qytetarëve, për objekte që në terren dhe faktikisht nuk rezultojnë të jenë ndërtuar në pronat fqinje. Deri në marrjen e masave, ASHK të udhëzojë drejtoritë vendore për të mbajtur një regjistër të veçantë të atyre dosjeve të legalizimit që përmbajnë zhvendosje hartografike të objekteve.
- Në drejtim të legalizimeve në zonat bregdetare: Të përcaktojnë qartë në kriteret për legalizim, neni 17, të ligjit 20/2020 moscenimin e rërës, zonës së plazhit dhe sipërfaqeve ujore, bregut detar, liqenor dhe lumor. Për këtë qëllim, të ndryshohet parashikimi i VKM nr.1040/2020, Kreu III, pika (dh) me një riformulim ku të përcaktohet refuzimi i legalizimit për rastet kur planet e përgjithshme vendore (PPV) e bashkive kanë përcaktuar për ndërtim zona bregdetare, përfshirë brezin ranor, me distanca më të vogla se 200m.
- Në drejtim të legalizimeve në zonat e mbrojtura: Të përcaktojnë në kriteret për legalizim, neni 17, të ligjit nr.20//2020, moscenimin e zonave të mbrojtura, me qëllim shmangien e interpretimeve ligjore, për shkak të

kontradiktës mes ligjit dhe VKM nr.1040/2020, të cilat mund të çojnë në një keqzbatim të kuadrit rregullator nga ana e drejtorive vendore dhe ngritjes së pretendimeve nga ana e subjekteve për legalizim, në kushtet kur ligji vet nuk e ndalon një gjë të tillë.

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për krijimin e një regjistri të veçantë, ku të evidentohen të gjitha planet e përgjithshme vendore (PPV) të bashkive, si rasti i bashkive Lezhë dhe Himarë, për të cilat janë miratuar si zonë për ndërtimi sipërfaqe bregdetare, ranore, shkëmbore etj., bazuar në tipologjitë natyrore të bregdetit shqiptar. Përmes një urdhri të veçantë të udhëzohen drejtoritë vendore për refuzimin e kërkesave për legalizim për ato subjekte që kanë ndërtuar në zona ranore apo me distanca më pak se 200 m nga bregu i detit.
- ASHK të marrë masa organizative apo ligjore për ta integruar procesin e informalitetit të ndërtimeve në linjë me faktorët e tjerë ekonomikë, socialë dhe të politikave urbanistike. Për rrjedhojë, përveç përmirësimit të bazës ligjore për adresimin e këtij problemi, të bëhen përpjekje në kuadër dhe të përmirësimit të ligjeve të programeve sociale të strehimit, të rregullimit të tregut të banesave, të planifikimeve urbane etj.
- ASHK të marrë masa për hartimin e një rregulloreje për punësimin në ASHK, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe forcimin e qëndrueshmërisë së DVASHK-ve duke hartuar politika rekrutimi, bazuar në kriteret e qarta profesionale veçanërisht për pozicionin e juristit, hartografit apo gjeodetit.
- Në drejtim të adresimit të pasojave të tërmetit, ASHK të marrë masa për përmirësime ligjore për të përfshirë në dokumentacionin ligjor akt-ekspertimin për ndërtime informale mbi 2 kate. Në këtë kuadër, të hartojë në mënyrë hartografike një regjistër risqesh për zona me rrezik të lartë tektonik si dhe të evidentojë të gjithë objektet informale të legalizuar që kanë patur ndërtime të mëdha strukturore nga tërmeti, duke përcaktuar kriteret e reja legalizimi që adresojnë problemet e qëndrueshmërisë së ndërtimeve informale.
- Në drejtim të mbrojtjes së pasurive shtetërore, ASHK të marrë masa për përmirësime ligjore që në rastet kur ndërtimi informal është ngritur mbi objekte shtetërore, të mos vijohet me legalizimin duke u kufizuar vetëm në një deklaratë noteriale, pa marrë konfirmimin nga inspektoratet e mbrojtës së territorit të bashkive, me qëllim për të provuar nëse objekti është shembur për arsye amortizimi/natyrore apo nga veprimtaria njerëzore.
- Në drejtim të mbrojtjes së pasurive shtetërore, ASHK të marrë masa për përmirësime ligjore që në rastet kur ndërtimi informal është ngritur mbi

objekte shtetërore, të mos vijohet me legalizimin duke u kufizuar vetëm në një deklaratë noteriale, pa marrë konfirmimin nga inspektoratet e mbrojtës së territorit të bashkive, me qëllim për të provuar nëse objekti është shembur për arsye amortizimi/natyrore apo nga veprimtaria njerëzore.

- Në drejtim të legalizimeve të objekteve të ndërtuara para datës 10.08.1991 të miratojë një udhëzues për trajtimin e këtyre rasteve, bazuar edhe në çështjet e dala gjatë zbatimit të VKM nr.827/2020, të cilat nuk kanë gjetur adresim në këtë vendim si dhe të ngrejë një sektor të veçantë në çdo drejtori për mbulimin e këtij lloji legalizimi.
- Në drejtim të reduktimit të ndërtimeve informale, ASHK të shqyrtojë mundësinë, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, që të propozojë një set masash reformuese për procedurat, afatin dhe kostot në marrjen e lejes së ndërtimit, me qëllim që të reduktohet numri i ndërtimeve informale.
- ASHK në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim që të jetë pjesë e grupit të punës gjatë fazës së hartimit, miratimit dhe zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, për shmangien e situatave të paparashikuara, që mund të ndikojnë negativisht në procesin e legalizimit dhe rritjen e efektivitetit të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

EFEKTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË REGJISTRIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Pyetja kryesore

A kanë qenë efektive masat e marra për përmirësimin e sistemit të regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme?

Mesazhi i auditimit:

Veprimet e ndërmarra vitet e fundit sa i takon përmirësimeve në kuadrin ligjor, përbëjnë një përpjekje serioze, të vlerësueshme dhe pozitive për të çelur një horizont të ri zgjidhjesh për çështjen shumë të diskutuar të pronave dhe përshpejtimin e regjistrimit të pasurive. Megjithatë efektet nuk kanë qenë plotësisht të dukshme, pasi konstatohen paqartësi lidhur me garantimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe mangësi në kapacitete logjistike dhe burimesh njerëzore për finalizimin e procesit të regjistrimit dhe përditësimin të pronave. Fokusi në të ardhmen duhet të jetë fillimisht drejt identifikimit të saktë të problematikave që kanë penguar këtë proces, e më tej në hartimin e planeve të masave për zgjidhjen e tyre dhe finalizimin e procesit të regjistrimit dhe

përditësimin të pronave, për ti hapur rrugë më tej reformave në sektorin e pronave në vend.

Subjektet e audituara:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, DVASHK-të: Lezhë; Fier; Vlorë

Deri më sot nuk është kryer asnjë auditim performance sa i takon sektorit të pronave në vend, megjithatë ndër auditimet e përputhshmërisë që realizohen rregullisht çdo vit përgjithësisht janë konstatuar mangësitë si vijon:

- Ndryshimi i statusit të parcelave të legalizuar nga “arë”, “pyll” “ranishte” etj në truall;
- Regjistrimi në bashkëpronësi të paligjshme të pasurive bujqësore;
- Mosevidentimi dhe mosrespektimi i procedurave të regjistrimit të pronave me mbivendosje;
- Tjetërsimi i pronave publike, falsifikimi i dokumentacionit të pronësisë me qëllim përfitimin padrejtësisht të titujve të pronësisë në zonat turistike dhe bregdetare;
- Keqmenaxhim i zonave kadastrale dhe mospasqyrim i saktë i gjendjes së pasurive; bujqësore në Kartelat e Pasurive të Paluajtshme;
- Zonat Kadastrale të pa menaxhuara dhe të pa përfshira në Sistemin e Regjistrimit Fillestar.

Mbi Auditimin

Ky auditim do të adresojë kryesisht efektivitetin e masave të marra dhe do të vlerësojë impaktin e tyre në përmirësimin e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Objektivi i tij është të gjenerojë një informacion mbi situatën aktuale sa i takon regjistrimit të pronave, si dhe të ofrojë rekomandime me qëllim përmirësimin e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bazuar në praktikën më të mira evropiane.

Ndonëse ka një vendim të Këshillit të Ministrave për dixhitalizimin e regjistrimit të pronave me VKM Nr. 688, datë 29.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përfutur nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”, procesi i dixhitalizimit të regjistrimit të pronave të përcaktuar në të nuk ka përfunduar sipas afatit të parashikuar, dhjetor 2018. Po kështu edhe sa i takon regjistrimit fillestar dhe përditësimin të tyre, ende nuk janë përfunduar këto procese. Për këtë arsye, fokusi kryesor i auditimit do të jetë në progresin e bërë dhe gjendjen aktuale të procesit të regjistrimit të pronave duke përfshirë problematikat si vijon:

- Gabimet e shumta hartografike të cilat kanë sjellë mbivendosje;
- Mospërputhja mes hartave dixhitale dhe atyre të administruara nga ZVRPP-të;
- Kapacitete të ulëta profesionale e në burime njerëzore;
- Ndryshimet e shpeshta të stafit;
- Mungesa e procedurave të unifikuara;
- Ndryshimi i statusit të parcelave të legalizuar nga “arrë”, “pyll” “ranishte” etj. në truall;
- Mosevidentimi dhe mos respektimi i procedurave të regjistrimit të pronave me mbivendosje, etj.

Lidhur me gjetjet kryesore të këtij auditimi subjekteve të audituar, ndër të tjera, u është rekomanduar marrja e masave të mëposhtme:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës të hartojë një manual ose rregullore të re mbi mënyrën e funksionimit të proceseve regjistruese dhe kalimtare të pronësisë në DVASHK-të, marrë parasysh se me kuadrin e ri ligjor janë vendosur rregulla të reja të regjistrimit të AMTP-ve dhe titujve të tjerë të pronësisë të cilat janë të përgjithshme dhe kërkojnë një trajtim teknik e më të hollësishëm për zbatim;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për ngritjen e një task force në bashkëpunim me bashkitë, qarqet si dhe institucione të tjera për identifikimin e atyre AMTP-ve që përfshijnë pasuri të patjetërsueshme publike si dhe të paraqesë në mënyrë hartografike se cilat pasuri publike preken nga këto AMTP. Në këtë kuadër, për të gjitha AMTP-të e regjistruara të cilat përfshijnë pasuri publike të patjetërsueshme, ASHK të hartojë një preventiv mbi kostot që do të ketë buxheti i shtetit nga ky proces i ri kompensimi;
- ASHK të marrë në analizë arsyet dhe shkaktarët e vonesave në ofrimin e shërbimeve/përgjigjeve ndaj qytetarëve dhe të veprojë për eliminimin e tyre;
- ASHK të marrë masa për ngritjen e një sistemi të ri licencimi për hartografët, duke shqyrtuar edhe propozimin e ndryshimeve ligjore me qëllim që licencimi i hartografëve të bëhet jo vetëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës ose licencimit drejtpërdrejt nga ASHK-ja, bazuar edhe në praktikën e mira në këtë fushë.
- ASHK të ngrejë një grup pune me qëllim veçimin e të dhënave kadastrale të sakta dhe të besueshme nga ato për të cilat ka dyshime për pasaktësi, duke i veçuar si të dhëna të klasit A (të sakta dhe të miratuara), të klasit B (duken që janë të sakta bazuar në vijëzimet e ortografisë) dhe të klasit C (kur nuk përputhen me vijëzimet e ortofotos ose ka mbivendosje me të dhëna të tjera).

Për këtë të fundit, në Kartelat e Pasurive të Paluajtshme të vendoset një shënim se “Ka nevojë për një plan rilevim të ri”;

- ASHK të nxjerrë një urdhër të veçantë me qëllim që DVASHK-të të evidentojnë në një regjistër të veçantë të gjitha pasuritë me mbivendosje, të cilat në seksionin “E” të kartelës përkatëse të shoqërohen me shënimin “Ndalohen veprimet mbi pasurinë deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga mbivendosja”.
- Sektori i procedurave të transferimit të pronës shtetërore në ASHK të marrë masa që të kërkojë nga bashkitë numrin e aplikimeve që janë kryer pranë DVASHK-ve përkatëse për regjistrimin e pasurive. Në bazë të këtij informacioni të hartojë një statistikë të përvitshme mbi ecurinë e regjistrimit të pasurive shtetërore.
- ASHK të ngrejë një grup pune për identifikimin e problemeve në sistemin IPS si dhe të marrë masa për ndërhyrjet e nevojshme për përmirësimin e sistemit elektronik.
- ASHK të marrë në analizë dhe të hartojë një plan masash për përsheptimin e procesit të regjistrimit fillestar në ZK e mbetura, ku të saktësojë fondin e nevojshëm, periudhën ekzakte deri në përfundim të projektit, si dhe burimet e financimit me vlerat përkatëse të nevojshme.
- Në funksion të përsheptimit të procesit të regjistrimit të ZK të mbetura, ASHK të marrë masa për përdorimin me eficiencë të të gjithë burimeve njerëzore në dispozicion, duke angazhuar për këtë qëllim të gjithë numrin e punonjësve të miratuar nga Bordi Drejtues.

FONDI REZERVË NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Pyetja kryesore | A është menaxhuar me eficiencë dhe efektivitet Fondi Rezervë nga ISSH?

Mesazhi i auditimit:

“Menaxhimi i fondit rezervë, edhe pse një ndër objektivat prioritar të ISSH-së, nuk është përmbushur me efektivitet dhe eficiencë. Qëllimi i krijimit të këtij fondi është sigurimi i një rezerve koherente për të përballuar përfitimet e skemës së sigurimeve shoqërore në raste të jashtëzakonshme.

Ulja e nivelit të sigurimit të skemës së pensioneve nëpërmjet fondit rezervë nga 3 muaj në 1 muaj jo vetëm çënon objektivin e këtij fondi, por çënon gjithashtu edhe parimin e sigurisë juridike për qytetarët, i cili është një parim kushtetues që shërben si bazë për funksionimin e shtetit të së drejtës, pasi riskon të drejtat e tyre në një masë më të madhe sesa përcaktimi ligjor i mëparshëm.

ISSH nuk ka kryer analiza të detajuara kosto/përfitim lidhur me alternativat e mundshme të investimit të fondit rezervë, të cilat do të mundësonin maksimizimin e përfitimeve financiare të gjeneruara nga investimi i këtij fondi dhe investimin e tij në mënyrë efektive. Pas maturimit të instrumenteve financiare, bazuar në publikimet për alternativat investuese në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë në atë periudhë, ISSH ka ri investuar kryesisht në të njëjtat mjete, dhe vlera të njëjta, me përjashtim të atyre instrumenteve financiare që u shtohet edhe vlera për të cilën është bërë edhe rritja e normës së fondit rezervë. Kështu, nuk evidentohet të jetë kryer një analizë apo përlllogaritje nga ana e subjektit të audituar mbi përzgjedhjen e vlerës së instrumentit financiar të investuar në bono thesari apo obligacione. Aktualisht, pas përmbushjes së objektivit ligjor për nivelin e sigurimit nëpërmjet fondit rezervë, ISSH nuk ka parashikuar asnjë objektiv për administrimin në vazhdim dhe investimin e këtij fondi me qëllim rritjen e tij.

Pavarësisht përpjekjeve, ISSH nuk ka menaxhuar me efektivitet të gjitha problematikat që ndikuan në sistemin e pensioneve dhe përfituesve të skemës gjatë periudhës së pandemisë. ISSH nuk e ka përdorur fondin rezervë gjatë periudhës së pandemisë edhe pse doli në pah nevoja e përdorimit të këtij fondi si pasojë e uljes së të ardhurave nga kontributet. Gjithashtu, ISSH nuk ka përgatitur një plan masash që përcakton në mënyrë të detajuar menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme dhe përcaktimin e rasteve eksplicite të përdorimit të fondit rezervë.”

Subjektet e audituara:

-Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Periudha e auditimit: 2015 – 2020.

Mbi Auditimin

Ky auditim u fokusua në performancën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, krahas menaxhimit të fondit rezervë, duke shqyrtuar rregullimin ligjor të këtij fondi, investimin e tij dhe përdorimin gjatë periudhës së pandemisë. Periudha nën auditim ishin vitet 2015-2020, me fokus më të madh në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020. Pas ngritjes së pyetjes kryesore të auditimit “A është menaxhuar me eficiency dhe efektivitet Fondi Rezervë nga ISSH?” dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, KLSH lidhur me gjetjet kryesore të këtij auditimi subjekteve të audituar, ndër të tjera, u është rekomanduar marrja e masave të mëposhtme:

- ISSH të analizojë efektet dhe të rishikojë edhe njëherë afatin e detyrueshëm të përcaktuar, për mbulim nëpërmjet fondit rezervë, duke mbajtur në konsideratë dhe reflektuar me vëmendje qëllimin e krijimit të këtij fondi nga

ligjvënësi, udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes Sociale (ISSA) dhe praktikat e mira.

- ISSH të krijojë një strategji ose udhëzues për menaxhimin e fondit rezervë, duke i dhënë një fokus më të madh këtij fondi gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale, sikurse përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore mbi bazë dhe për zbatim të të cilave ai vepron. Gjatë hartimit të kësaj strategjie të merren në konsideratë praktikat e mira dhe udhëzuesit e ISSA, me qëllim përcaktimin e objektivave SMART që lidhen me menaxhimin e këtij fondi.
- ISSH, si institucioni shtetëror i ngarkuar për administrimin e sigurimeve shoqërore, të garantojë përputhshmëri ndërmjet ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi që ISSH nxjerr, duke eliminuar konfliktet midis dispozitave të ndryshme ligjore e nënligjore, me qëllim që implementimi i tyre të jetë sa më efektiv.
- Gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore, ISSH duhet të tregojë kujdes të veçantë në hartimin e tyre dhe të sigurohet që këto akte kanë në përmbajtjen e tyre të gjithë elementët e domosdoshëm të tekstit zyrtar.
- ISSH ta trajtojë përcaktimin ligjor të nenit 70 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) si periudhë minimale të shpenzimeve që duhet të mbulojë fondi rezervë. Maj 2021 e në vazhdim.
- Njësia e ngritur në ISSH për investimin e fondit rezervë, të kryejë analiza reale kosto përfitim për studimin e normave të interesit, instrumenteve financiare në treg, riskun, dhe likuiditetin që ato ofrojnë, me qëllim garantimin e investimit efektiv të fondit rezervë, diversifikimin e portofolit, dhe rritjen e tij.
- KA të garantojë një pozicion më aktiv në investimin e fondit rezervë, në përmbushje të rolit të tij vendimmarrës, duke mos u mjaftuar në mbledhjet formale për miratimin e rezultatit financiar të vitit dhe shtesës së fondit rezervë.
- ISSH, të garantojë një bashkëpunim më efektiv me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim shqyrtimin e alternativave të instrumenteve financiare që do të emëtohen në periudhat e ardhshme për investimin e fondit rezervë, duke komunikuar në mënyrë të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve dhe dokumentimin e këtij bashkëpunimi me minuta takimi dhe gjurmë të tjera auditimi.
- ISSH, si institucioni teknik kompetent në administrimin e skemës së sigurimeve shoqërore, të marrë masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e bërës ligjore dhe përcaktimin në mënyrë eksplicite të rasteve të përdorimit të fondit rezervë.

- Duke marrë në konsideratë numrin e lartë të ankesave dhe kërkesave drejtuar në ISSH, Instituti i Sigurimeve Shoqërore duhet të marrë masat për vendosjen e disa numrave telefonik në dispozicion të qytetarëve, të cilët të funksionojnë nga ora 08:00- 20:00, duke iu ofruar qytetarëve shërbim të shpejtë dhe cilësor për t'i qartësuar ata në lidhje me pretendimet tyre.
- Lidhur me problematikat e konstatuara nga procesi i cunguar i dixhitalizimit të arkivës, ku për periudhën 1994-2011 dokumentet e vjetërsisë (regjistra, libra page, bordero, listë-pagesa) nuk janë të dixhitalizuara dhe për verifikimin e viteve të punës gjatë kësaj periudhe duhet të bëhet verifikimi fizik, i cili është shumë burokratik dhe shpeshherë cënon të drejtën e qytetarëve duke tejkaluar afatin ligjor të lidhjes së pensioneve, propozojmë që kjo çështje të trajtohet më imtësisht në auditimin e rradhës që KLSH do të kryejë në ISSH, duke vlerësuar mundësinë e hartimit të një projekt-propozim nga ana e ISSH mbi dixhitalizimin e arkivës qendrore të sigurimeve shoqërore për vitet 1994 – 2011 dhe njëkohësisht analizuar përfitimet që do të sjellë në sistemin e pensioneve zbatimi i këtij projekti.

EFEKTIVITETI I POLITIKAVE NË RUAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E SITEVE ARKEOLOGJIKE, PËR PERIUdhËN 2016-2019

Pyetja kryesore | A kanë rezultuar efektive politikat për menaxhimin e siteve arkeologjike për periudhën 2016 - 2019?

Mesazhi i auditimit:

Politikat shtetërore të ndjekura nga Ministria e Kulturës, si ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e siteve arkeologjike, për shkak të mungesës së një kuadri rregullator të plotë në menaxhimin e tyre, nuk kanë rezultuar efektive. Mbivendosja e legjislacionit, si pasojë e funksionimit të njëkohshëm të dy ligjeve për trashëgiminë kulturore, mungesa e akteve nënligjore zbatuese, miratimi i dokumentit strategjik pa plane konkrete veprimi, komunikimi ndërinstytucional i dobët, kanë bërë që menaxhimi i siteve të mos jenë efektiv. Përzgjedhja e kriterëve të menaxhimit nuk është bërë mbi bazën e studimeve të kryera nga Ministria e Kulturës, si dhe modelit më të mire, të integruar në kushtet shqiptare. Ndryshimi i strukturave të organizimit, funksionimit dhe administrimit të NJAKPA-ve është kryer pa analiza financiare, pa analiza burimesh njerëzore dhe nevojash për aftësi profesionale specifike, pa një planifikim mbi nevojat e konstatuara dhe rezultatet e dëshiruara.

Ministria e Kulturës, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore dhe NJAKPA-të kanë shfaqur dobësi në marrjen e masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të parqeve arkeologjike. Në mungesë të planeve për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore,

menaxhimi i siteve në këtë aspekt, nuk ka pasur efektivitet të plotë. Mangësitë infrastrukturore, logjistike dhe njerzore, në administrimin e parqeve, janë bërë pengesë për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për shfrytëzimin publik të tyre, nga ana e vizitorëve. Mangësi konstatohen edhe në promovimin e tyre nëpërmjet kanaleve të komunikimit masiv. Ministria e Kulturës nuk ka asnjë plan veprimi, sa i takon marrëdhëniet me mediat vizive, lidhur me prodhimin, promovimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi sitet arkeologjike

Subjektet e audituara:

- Ministria e Kulturës;
- Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Vlorë, lidhur me menaxhimin e parqeve arkeologjike të Amantias dhe Orikumit;
- Parku Arkeologjik Kombëtar Butrint;
- Njësia e Administrimit dhe Kordinimit të Parqeve Arkeologjike Apolloni dhe Bylis.

Periudha e auditimit: 2016 – 2019.

Mbi Auditimin

Sitet arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, të çfarëdo lloj natyre dhe kulture, mjedisi social dhe natyror, përkatësi të të njëjtit civilizim klasik mesdhetar, varësie, menaxhimi, madhësie apo pozicioni gjeografik ku ndodhen, kanë qenë dhe do të mbeten një faktor i rëndësishëm i zhvillimit historik, kulturor dhe social ekonomik në vendin tonë. Sitet arkeologjike krijojnë mundësinë e nxitjes dhe aktivizimit të të mirave materiale dhe shërbimeve, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht të komuniteteve përreth, të cilët e kanë kuptuar se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me kontekstin në të cilin jetojnë dhe punojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor dhe shërben si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës. Meqenëse trashëgimia kulturore materiale është një prej burimeve më të rëndësishme kombëtare në vend, i cili nuk ripërtërihet, duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi.

Gjykuar në sa më sipër, për shkak të vlerave që mbart menaxhimi i siteve arkeologjike, problemi social në fokus është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i tyre, si domosdoshmëri për zhvillimin e kulturës, ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies kombëtare. Duke marrë parasysh shqetësimin e opinionit publik të shprehur së fundmi në media dhe forume të ndryshme, lidhur me dëmet që po i shkaktohen kësaj pasurie kulturore, e konsideruam të rëndësishëm

kryerjen e auditimit, duke u fokusuar më konkretisht. Mosrealizimi në mënyrë efektive i funksioneve parësore të subjekteve nën auditim, përbën një dëm të konsiderueshëm në aspektin kulturor, social, por edhe ekonomik në vend.

Lidhur me gjetjet kryesore të këtij auditimi subjekteve të audituar, ndër të tjera, u është rekomanduar marrja e masave të mëposhtme:

- Ministria e Kulturës dhe strukturat përgjegjëse, në zbatim të Ligjit Nr. 27/2018, të hartojnë planin e veprimit të realizimit dhe raportimit të realizimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025.
- Ministria e Kulturës të rishikojë aktet nënligjore për funksionimin e BKPA-së dhe të dokumentojë veprimtarinë e tij për marrjen e vendimeve lidhur me sitet arkeologjike.
- Ministria e Kulturës, bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, sipas fushës së përgjegjesisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, të propozojë, të hartojë dhe të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave Planin Kombëtar të Peizazhit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 27/2018, ligjit të planifikimit të territorit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara, për kontrollin e zonave të mbrojtura të siteve arkeologjike si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të tij.
- Ministria e Kulturës, të rishikojë legjislacionin aktual, për të saktësuar dhe rregulluar hierarkinë e institucioneve qendrore dhe të këshillave kombëtare që ekzistojnë brenda sistemit të trashëgimisë kulturore dhe procedurat e vendimmarrjes së tyre për sitet arkeologjike, për të shmangur mbivendosjen e kompetencave.
- Ministria e Kulturës në bashkëpunim me NJAKPA-të dhe DRTK-të, bazuar në strategjinë e miratuar dhe me hartimin e menjëhershëm të planit të veprimit për realizimin e saj, të mundësojë hartimin e strategjive të koordinimit dhe monitorimit të projekteve me donatorët në sitet arkeologjike.
- Ministria e Kulturës në zbatim të pikave 1 dhe 4, të nenit 102, të Ligjit Nr. 27/2018, të miratojë udhëzimin për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe të peizazhit dhe procedurën e përzgjedhjes së subjekteve.
- Ministria e Kulturës, bazuar në nenet 243 dhe 244 të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, të hartojë planet kombëtare të peizazhit, në përputhje me dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, ligjit të planifikimit të territorit dhe

marrëveshjeve ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore të peizazhit, të ratifikuara, për kontrollin e zonave të mbrojtura të parqeve si dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda zonës së mbrojtur të parkut.

- Institucionet e specializuara përgjegjëse dhe Ministria e Kulturës të marrin masa të përfundojnë hartimin dhe miratimin e kriterëve të hulumtimeve arkeologjike dhe standardet e kriteret për gjurmimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore materiale si dhe mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore.
- Ministria e Kulturës, në koordinim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Njësinë e Administrimit e Koordinimit të Parqeve Kombëtare Apolloni Bylis dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë të marrin masa për hartimin e Planeve për ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave të paluajtshme kulturore për parqet arkeologjike. Nëpërmjet një plani afatgjatë të synohet ndërtimi i një sistemi menaxhimi modern i këtyre parqeve arkeologjike duke përfshirë restaurimin dhe konservimin e monumenteve, rehabilitimin tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, duke pasur si qëllim shndërrimin e tyre në qendra me atraktive.
- Ministria e Kulturës të përgatisë dhe t'i propozojë Agjencisë Kombëtare të Turizmit nënshkrimin e një “Memorandumi bashkëpunimi”, lidhur me mënyrën dhe kriteret e promovimit të parqeve arkeologjike shqiptare, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Ministria e Kulturës së bashku me institucionet e varësisë, të ngrejë një grup pune me synim përgatitjen e një plani ndërveprimi me shoqatat e operatorëve turistikë, i cili duhet të ketë si objektiv, nxitjen e përfshirjes së siteve arkeologjike shqiptare në stacionet e itinerareve turistike të të huajve që vizitojnë Shqipërinë.
- Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë të cilat administrojnë sitet arkeologjike, të ngrejë një grup pune, i cili duhet të përgatisë një plan veprimi që parashikon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, si me Televizionin Publik Shqiptar, për realizimin dhe transmetimin e dokumentarëve mbi parqet dhe trasmetimin e tyre periodik, ashtu dhe me televizionet private, të cilat të angazhohen që reportazhe dhe dokumentarë mbi realitetin arkeologjik shqiptar të bëhen pjesë e programeve të tyre tematike.

MËMËSIA E SIGURT: KUJDESI SHËNDETËSOR SPITALOR NATAL DHE POSTNATAL

Pyetja kryesore | A është garantuar kujdes spitalor shëndetësor eficient dhe efektiv për mëmësinë e sigurt në vendin tonë nga

institucionet përgjegjëse për vendin tonë për periudhën 2016 – 2019?

Mesazhi i auditimit:

Angazhimi i MSHMS në drejtim të ofrimit të kujdesit shëndetësor spitalor për mëmësinë e sigurt referuar objektivave të Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017 – 2021 nuk ka qenë efektiv, për aq kohë sa ky institucion nuk ka mundur të krijojë kushtet e duhura për zbatimin e plotë të tyre. Monitorimi dhe vlerësimi i Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues nuk kanë ekzistuar për periudhën 2016 – 2019, duke penalizuar kështu analizimin dhe verifikimin e rezultateve të arritura si rrjedhojë e zbatimit të këtyre objektivave. MSHMS nuk ka kryer një vlerësim gjithëpërfshirës dhe serioz të nevojës për burime njerëzore në strukturat shëndetësore të kujdesit spitalor, që analizojnë ngarkesën e punës për mjek, raportin numër pacientësh për mjek, duke përfshirë këtu edhe numrin e shtretërve me qëllim një përdorim sa më eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore në dispozicion të sistemit shëndetësor.

Problematikat e infrastrukturës spitalore kanë penalizuar ofrimin e shërbimit, duke qenë se ende nuk garantojnë kushtet optimale në përputhje me Standardet e Cilësisë për Akreditimin e Strukturave Shëndetësore Universitare dhe atyre Spitalore dhe nuk ofrohet një shërbim i cili siguron nivelin më të lartë të pastërtisë, higjienës dhe sterilitetit, që, me gjithë përpjekjet e pareshtura të personelit shëndetësor, ende mbetet në nivele jo të kënaqshme.

Mangësitë në administrimin dhe dokumentimin e trajnimeve të kryera nga stafi mjekësor nga ana e specialistëve për edukimin në vazhdim, referuar shërbimit obstetrik – gjinekologjik, nuk lejon gjurmimin dhe raportimin e saktë të gjitha trajnimeve të kryera nga stafi për periudhën objekt auditimi, si edhe penalizon vetë strukturat shëndetësore të cilat në këtë mënyrë nuk posedojnë të dhëna të sakta për avancimet profesionale të stafit.

Subjektet e audituara:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
- Spitalet Universitare Obstetrikë - Gjinekologjik “Koço Gliozheni” dhe “Mbretëresha Geraldinë”
- Spitalet Rajonale Vlorë dhe Korçë

Periudha e auditimit: 2016 – 2019.

Mbi Auditimin

Kujdesi shëndetësor amtar në drejtim të promovimit të mëmësisë së sigurt është një temë shumë e rëndësishme në fushën e shëndetësisë, për të cilën OBSH ka hartuar një strategji të dedikuar – Strategjia Globale mbi shëndetin e Gruas dhe të fëmijës 2016-2023, në të cilën mëmësia e sigurt përkufizohet si kujdes shëndetësor para konceptimit, kujdes prenatal, natal dhe postnatal, parandalimi i problemeve të të porsalindurit dhe anomalive kongenitale. Kjo temë ka qënë shpesh herë në fokusin e medias së shkruar, sidomos sa i takon shërbimit në nivel spitalor, duke nxjerr në pah problematika lidhur me vdekshmërinë foshnjore dhe amtare; aftësitë dhe njohuritë e personelit shëndetësor; mungësën e standardeve udhëzimeve, protokolleve të referimit të ndjekjes së gruas gjatë shtatzanisë, lindjes dhe pas lindjes; mungesën e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës. Lidhur me gjetjet kryesore të këtij auditimi subjekteve të audituar, ndër të tjera, u është rekomanduar marrja e masave të mëposhtme:

- MSHMS të ushtrojë kompetencat e saj në kuadër të hartimit dhe përmirësimit të bazave ligjore dhe rregulloreve për “Sigurimin e cilësisë në shërbimin amtar dhe neonatal” referuar Dokumentit Strategjik dhe Planin e Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues.
- MSHMS, në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor”, i ndryshuar, të ndërmarrë të gjitha hapat ligjore të nevojshme për të hartuar dhe propozuar pranë Këshillit të Ministrave, Planin Shtetëror Spitalor.
- MSHMS të marrë të gjitha iniciativat e nevojshme, brenda kompetencave ligjore, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë në drejtim të përditësimit dhe përmirësimit të cilësisë së kurrikulave universitare të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Infermierisë lidhur me kujdesin amtar.
- MSHMS të kryej një vlerësim të veçantë sa i takon infrastrukturës, burimeve njerëzore, dhe pajisjeve mjekësore të institucioneve shëndetësore spitalore që ofrojnë kujdes amtar dhe perinatal.
- MSHMS të krijojë regjistrin kombëtar për të dhënat mbi shkaqet e çdo vdekjeje amtare të analizuar nëpërmjet sistemit të auditimit të OBSH-së, si dhe të rasteve me sëmundshmëri të rëndë amtare nëpërmjet qasjes së raportimit të rasteve të rënda, pothuajse pranë vdekjes (near miss cases reporting approach).
- MSHMS të kryej, për të gjitha maternitetet, vlerësimin e cilësisë së materniteteve publike të vendit mbi bazën e mjetit të adoptuar nga OBSH-ja për auditimin klinik.
- MSHMS të marrë masa për të kryer çdo 2 vjet analizat për pengesat e ndryshme, përfshirë edhe ato financiare për arritjen e mbulimit të plotë të paketave të ndërhyrjeve efektive për kujdesin cilësor për nënën dhe foshnjën

e porsalindur, si dhe zhvillimi i ndërhyrjeve kombëtare për të hequr këto pengesa.


- MSHMS të marrë masa për të kryer një vlerësim gjithëpërfshirës të objektivave të Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Shëndetin Seksuale dhe Riprodhues në të cilin të evidentohet qartë statusi i zbatimit të dokumentit deri në fund të periudhës 2017 – 2020 e të raportojë për të në Komisionin Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
- MSHMS të hartojë strategjinë e radhës për shëndetin seksual dhe riprodhues në përputhje me kriterin SMART, duke parashikuar objektiva specifike, të matshme, të realizueshme, realiste dhe me afat të përcaktuar, nëpërmjet të cilave të evidentohen me saktësi fondet e parashikuara dhe institucionet e ngarkuara për zbatimin e tyre, e të ngrejë për këtë qëllim një sistem monitorimi e vlerësimi eficient me strukturat përkatëse përgjegjëse për këtë funksion.
- MSHMS në kuadër të ofrimit të mëmësisë së sigurt dhe arritjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, të marrë masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve infrastrukturore në Spitalet Universitare dhe Rajonale të vendit, për të garantuar dhe siguruar përputhshmërinë me Standardet e Cilësisë për Akreditimin e Strukturave Shëndetësore Universitare dhe Spitalore.
- MSHMS, në kuadër të miratimit të Planit Shtetëror Spitalor, të rishikojë shpërndarjen e numrit të shtretërve në shërbimin spitalor në rang vendi, e veçanërisht për shërbimin obstetrik – gjinekologjik, duke vlerësuar konkretisht numrin e shtretërve, numrin e pacientëve, normën e shfrytëzimit të shtratit, numrin e mjekëve të nevojshëm, me qëllim garantimin e një shërbimi racional dhe optimal, e duke përmbledhur gjetjet nga ky vlerësim në një Raport të posaçëm të publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni.
- MSHMS të marrë masat e duhura në drejtim të hartimit të kurrikulave për trajnimin e detyrueshëm në edukimin në vazhdim të personelit shëndetësor, si dhe për përcaktimin e kuadrit rregullator për certifikimin dhe ricertifikimin periodik të gjithë personelit të trajnuar që ofron kujdes për foshnjën e porsalindur.

Gjetjet, Konkluzionet dhe Rekomandimet të ndara sipas dimensionit të 3E-ve të performancës

Tabela nr. 15 Dimensionet e Performancës së 3E-ve


Dim. Perf. 3E-te	Gjetje	Konkluzione	Rekomandime		
			Masa organizative	Për përmisim ligjor	Shuma
Ekonomicitet	61	40	57	12	69
Eficencë	1	3	3	2	5
Efektivitet	110	70	50	12	62
Total	172	113	110	26	136

Grafik nr.14 Gjetjet, konkluzionet në auditimet e performances



Burimi KLSH

Grafik nr.15 Masat e rekomanduara




Burimi KLSH

VI.REKOMANDIMET SIPAS NATYRËS

KLSH, gjatë periudhës janar – qershor 2021, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, administrative dhe disiplinore gjithsej janë 631, nga të cilat: 33 janë përmirësime ligjore, 189 rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 409 rekomandime organizative.

Grafik nr.16 Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën janar - qershor 2021



Burim KLSH

Masat disiplinore


Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara ka adresuar rekomandimet për masat disiplinore dhe administrative, subjekteve të audituara dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në media-n e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodin e Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 189 masave disiplinore dhe administrative, si më poshtë:

Tabela nr. 16 Masat disiplinore dhe administrative

Masa disiplinore bazuar në:		
I	Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 58:	87
1.	Vërejtje	-
2.	Mbajtja deri 1/3 të pagës	-
3.	Pezullim ngritje në detyrë	-
4.	“Largim nga shërbimi civil”	1


5.	Në kompetencë të titullarit (Nga Vërejtje deri në largim nga shërbimi civil)	86
II	Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës:	55
1.	Vërejtje	1
2.	Vërejtje më paralajmërim	1
3.	Zgjidhje Kontratës së Punës	2
4.	Në kompetencë të titullarit (Nga Vërejtje deri në largim nga puna)	51
III	Masat Administrative:	47
	Kompetencë të APP-së, IMTV-së, etj.	31
	Ministrisë, Linjës, Heqje Licence	16
IV	Shuma (I+II+III)	

Grafik nr. 17 Masa disiplinore bazuar në Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe në në Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës



Burimi KLSH

Grafik nr. 18 Masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën janar – qershor 2021



Burimi KLSH

Masat disiplinore dhe administrative janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 4, bashkëlidhur këtij Buletini statistikor.

Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative

Gjatë periudhës janar – qershor 2021 janë rekomanduar nga KLSH 442 rekomandime, për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masa organizative.

KLSH ka rekomanduar gjithsej 33 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, ndryshime që prekin nga rekomandime për amendime në korniza ligjore, raportimin financiar por edhe në përmirësime të kuadrit të brëndshëm rregullativ të institucioneve me synim forcimin e sistemeve të kontrollit të brëndshëm dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike etj.

Gjithashtu KLSH ka rekomanduar 409 masa organizative, në drejtim të forcimit të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit.

Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 5 dhe 5.1, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

VII. Kallëzimet Penale

KLSH ka luftuar pa kompromis ndaj abuzimeve dhe mashtrimeve financiare me pronën publike, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike nëpërmjet thellimit të luftës pa kompromis ndaj zyrtarëve të korrumpuar, kryesisht adresimin e kallëzimeve penale me akuzat “Shpërdorim detyre”, “Shkelje e barazisë në tendera”, etj.

KLSH nga auditimet e realizuara në gjashtëmuorin e parë të vitit 2021 ka përcjellë në Prokurori **2 kallëzime penale**.

Kallëzim Penal

- 1) Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë dhe Bashkinë Sarandë (*Ish-Drejtor i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, Ish-Specialiste juriste e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, Ish-Specialist hartograf në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë*).
- 2) Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër (*Ish-Drejtor i Drejtorisë së Rajonit Vendor Shkodër, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, ish-Drejtor i Drejtorisë së Rajonit Vendor Shkodër, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, Përgjegjës i sektorit të menaxhimit të kontratave, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të preventivit të fondit limit, ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të preventivit të fondit limit*);

Për 2 kallëzimet penale të përcjella në Prokurori janë kallëzuar 7 persona të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH-së, për 4 drejtues të nivelit të lartë e të mesëm dhe 3 specialist.

Aneke

Evidenca nr.1

Institucionet e evaduara nga KLSH, për periudhën Janar - Qershor 2021

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT		
1	1	<i>Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2020"</i>
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE		
2	1	<i>Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2020"</i>
3	2	Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar Durrës
4	3	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (<i>Auditim Tematik</i>)
5	4	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
6	5	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
7	6	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE		
8	1	<i>Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2020"</i>
9	2	Bashkia Këlcyrë
10	3	Bashkia Konispol
11	4	Bashkia Krujë: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë
12	5	Bashkia Tiranë: "Mbi përputhshmërinë për projektin e partneritetit publik privat, ndërtimi i shkollave"
13	6	Bashkia Korçë
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE, DHE MJEDISIT		
14	1	<i>Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2020"</i>
15	2	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë
16	3	Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër
17	4	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë dhe Bashkia Sarandë
18	5	<i>Auditim Performance me temë: Efektiviteti i masave të marra për përmirësimin e sistemit të regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme</i>
19	6	<i>Auditim Performance me temë: Auditimi i Performances ne Agjencinë Shtetërore të Kadastrës: Efektiviteti Procesit te legalizimit dhe ndikimi na administrimin e pasurisë publike</i>
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA		
20	1	<i>Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2020"</i>
21	2	<i>Projekti: "Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara" (ADISA)</i>
22	3	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
23	4	<i>Projekti: "Modernizimi i Asistencës Sociale", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		
24	1	<i>Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin e I-rë të vitit 2020"</i>
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCES		
25	1	<i>Auditim Performance me temë: Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike</i>
26	2	<i>Auditim Performance me temë: Fondi i Emergjencës në Institutin e Sigurimeve Shoqërore</i>
27	3	<i>Auditim Performance me temë: Mëmësia e Sigurt: Kujdesi Shëndetësor Spitalor Natal dhe Postnatal</i>

Evidenca nr.2

Evidenca përmblledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuar në auditimet e ushtruara për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën Janar – Qershor 2021

Mijë lekë

Nr.	Subjektet	Gjithsej Zbuluar	Rekomanduar për zhdëmtim
1	Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar Durrës	247	247
2	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	10,912	10,912
3	Bashkia Këlcyrë	16,343	16,343
4	Bashkia Konispol	4,776	4,776
5	Bashkia Krujë, Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	7,105	7,105
6	Bashkia Korçë	13,017	13,017
7	Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër	27,219	27,219
8	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	67,974	67,974
9	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	7,940	7,940
10	Projekti: Ofrimi shërbimeve publike me në qendër qytetarin", ADISA	464	464
Totali		155,997	155,997

Evidenca e pasqyrimt të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cila kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit për periudhën Janar – Qershor 2021

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
1	Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar Durrës	0	215,626	215,626
2	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	0	223,429	223,429
3	Bashkia Këlcyrë	70,302	23,968	94,270
4	Bashkia Konispol	33,507	12,646	46,153
5	Bashkia Krujë, Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	0	40,672	40,672
6	Bashkinë Tiranë, Projekti: Partneriteti publik privat, ndërtimi i shkollave	0	51,291	51,291
7	Bashkia Korçë	316,083	0	316,083
8	Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër	0	83,135	83,135
9	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	613,480	33,470	646,950
10	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	0	881,418	881,418
11	<i>Auditim Performance: Mëmësia e Sigurt: Kujdesi Shëndetësor Spitalor Natal dhe Postnatal</i>	0	15,512	15,512
	Totali	1,033,372	1,581,167	2,614,539

Evidenca nr.4

**Evidenca e Masave Disiplinore dhe Administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën
Janar – Qershor 2021**

Në numër

Nr	Emërtimi i subjekteve	GITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
1	Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar Durrës	1	7	13
2	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	15	0	1
3	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Tematik)	1	0	0
4	Bashkia Këlcyrë	6	0	4
5	Bashkia Konispol	4	0	0
6	Bashkia Krujë, Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	1	0	8
7	Bashkia Korçë	0	0	7
8	Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër	0	4	11
9	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	59	0	3
10	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Sarandë (Tematik)	0	3	0
11	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	0	40	0
12	Projekti: Ofrimi shërbimeve publike me në qendër qytetarin", ADISA	0	1	0
TOTALI		87	55	47

Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Qershor 2021

Në numër

	SUBJEKTI	Ndryshime dhe përmirësime legjislacioni
		Rek.
1	Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar Durrës	4
2	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Tematik)	1
3	Bashkia Këlcyrë	2
4	<i>Auditim Performance:</i> Efektiviteti i procesit të legalizimit dhe ndikimi në administrimin e pasurisë publike	6
5	<i>Auditim Performance:</i> Efektiviteti i masave të marra për përmirësimin e sistemit të regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme	2
6	<i>Auditim Performance:</i> Mëmësia e Sigurt: Kujdesi Shëndetësor Spitalor Natal dhe Postnatal	3
7	<i>Auditim Performance:</i> Fondi Rezervë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore	3
8	<i>Auditim Performance:</i> Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019	12
TOTALI		33

Masat Organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Qershor 2021

Në numër

Nr	SUBJEKTI	Masa organizative
		Rekomanduar
1	Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar Durrës	46
2	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	36
3	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (<i>Tematik</i>)	4
4	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (<i>Tematik</i>)	4
5	Bashkia Këlcyrë	22
6	Bashkia Konispol	29
7	Bashkia Krujë Projekti: Rikonstruksion, procedurat e prishjes dhe procedurat për rindërtimin e shkollës 9/vjeçare, Thumanë	9
8	Bashkinë Tiranë, Projekti: Partneriteti publik privat, ndërtimi i shkollave	9
9	Bashkia Korçë	14
10	Drejtoria Rajonale e Rrugëve Shkodër	25
11	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë	16
12	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Sarandë (<i>Tematik</i>)	10
13	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	50
14	<i>Projekti: Modernizimi i Asistencës Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	12
15	<i>Projekti: Ofrimi shërbimeve publike me në qendër qytetarin, ADISA</i>	13
16	<i>Auditim Performance: Efektiviteti i procesit të legalizimit dhe ndikimi në administrimin e pasurisë publike</i>	23
17	<i>Auditim Performance: Efektiviteti i masave të marra për përmirësimin e sistemit të regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme</i>	13
18	<i>Auditim Performance: Mëmësia e Sigurt: Kujdesi Shëndetësor Spitalor Natal dhe Postnatal</i>	16
19	<i>Auditim Performance: Fondi Rezervë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore</i>	8
20	<i>Auditim Performance: Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e siteve arkeologjike, për periudhën 2016-2019</i>	50
TOTALI		409

EVIDENCA E KALLËZIMEVE PENALE PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2021

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot. data e kallëzimit	Nr. Pers	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Sarandë	Nr. Prot 784/16 Në datë 10.05.2021	3	1) Ish-Drejtor i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë; 2) Ish-Specialiste juriste e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë; 3) Ish specialist hartograf në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë.	Konsumim i figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
2	Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër	Nr. Prot 559/13 Në datë 10.05.2021	4	1) Ish-Drejtor i Drejtorisë së Rajonit Vendor Shkodër, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor; 2) Ish-Drejtor i Drejtorisë së Rajonit Vendor Shkodër, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor; 3) Përgjegjës i sektorit të menaxhimit të kontratave, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të preventivit të fondit limit; 4) ish-specialist, në cilësinë e anëtarit të grupit të hartimit të preventivit të fondit limit.	Konsumim i figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën Janar – Qershor 2021

<i>Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave</i>	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)
		E drejtë	Pa drejtë		
<i>Fushat kryesore të shqetësimit publik</i>					
Për administrim financiar dhe prokurime	29	15			14
Administrim dhe kthim të pronës	112	85		16	11
Taksa, Tatime e dogana	15	9			6
Të tjera	25	21			4
Total	181	130		16	35

